



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:053026

Datë: 27.02.2024

Numri i dokumentit: 05379699

KPPP.nr.837/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit “SEFERI GROUP” Sh.P.K., me seli në fshatin Gjinoc, Komuna e Suharekës, me NUI: 810103565, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.H. avokat nga Prizreni, kundër debitorit “INTER CONSTRUCTION GROUP” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, lagjja Mati 1, BII, A17, Obj II, Hy, 1/4-1, me NUI: 811482900, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.87/2023 të datës 19.04.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Mehdi Reshani, me seli në Prizren, jashtë seancës me datë 09.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit INTER CONSTRUCTION GROUP” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.87/2023 të datës 19.04.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Mehdi Reshani, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.
- II. Detyrohet debitori që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë sipas prapësimit të debitorit në shumë të përgjithshme prej 104 €, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim nga avokati.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.87/2023 të datës 19.04.2023, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përmbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturës nr.21-SHV01-001-116, të datës 25.10.2021, me të cilin ka urdhëruar që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri, t'ia paguajë kreditorit borxhin në shumën prej 3,120.00 Euro, me kamatëvonesë 8% vjetore, nga data e afatit për pagesë të çdo fature të lartcekur deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përmbaresit Privat, ka ushtruar prapësim debitori, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale nga neni 71 i LPP-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Tutje ka shtuar se urdhri i lejuar ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, dhe ekzistojnë kundërthënie në mes të dispozitivit të këtij urdhri dhe shkresave të lëndës. Ka theksuar se nuk dihet se kur është krijuar përmbushja e detyrimit, në cilën periudhë kohore apo për çfarë baze juridike është krijuar eventualisht ky detyrim. I ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit dhe të hudhet si i parregullt, apo të mbetet jashtë fuqisë urdhri i Përmbaresit Privat, si dhe të obligohet kreditori t'i paguaj shpenzimet në procedurë, për përpilimin e prapësimit shumën prej 156.00 Euro, sipas tarifës së OAK-së.

Kreditori, në përgjigje në prapësim, ka theksuar se debitori ka paraqitur prapësim vetëm për të zvarritur procedurën. Tutje ka shtuar se propozimit për përmbarim i është bashkangjitur fatura në origjinal, e cila gjendet në shkresat e lëndës të Përmbaresit për të cilën e ka edhe vet debitori, se të njëjtën e ka pranuar dhe nënshkruar, është e cekur se kush e kërkon borxhin dhe nga kush e kërkon, si dhe objektin dhe shumën e cila kërkohet, pra propozimi i përmbush të gjitha bazat për tu parashtruar si i tillë. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi si i pabazuar, ndërsa të mbetet në fuqi urdhri i Përmbaresit Privat, dhe të obligohet debitori që t'i paguajë të gjitha shpenzimet për avokatin sipas tarifës nr.9 të OAK-së, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, pretendimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentin e besueshëm faturën nr.21-SHV01-001-116, të datës 25.10.2021, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nr.21-SHV01-001-116, e datës 25.10.2021, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, e njëjta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin e debitorit.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se nuk dihet se kur është krijuar përmbushja e detyrimit, në cilën periudhë kohore apo për çfarë baze juridike është krijuar eventualisht ky detyrim, mirëpo gjeti se pretendimet e tilla nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore, prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par. 1 dhe 463 par.1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së. Gjykata e gjeti si të bazuar kërkesën e kreditorit për pagesë të shpenzimeve sa i përket përpilimit të përgjigjes në prapësim, ndërsa lartësinë e saj

gjkata e llogariti duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve të nxjerrë nga Oda e Avokatëve më 18 mars 2017, siç përcakton neni 453 par.2 i të LPK-së lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, ashtu që si bazë u mor lartësia e vlerës së përmbartimit, numri i palëve të përfaqësuar, si dhe lloji i veprimit procedural për të cilin janë kërkuar shpenzimet.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.837/23, me datë 09.02.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.